

# MBROJTJA E TË DHËNAVE PERSONALE

**QË MBLIDHEN, RUHEN DHE PËRPUNOHEN NË SISTEMET E INSTALUARA OSE TË INTEGRUARA NGA RATECH sh.p.k.**

---

1. Përgjegjësia për mbrojtjen e të dhënave personale i takon titullarit të sistemit, në kuadër të të cilit mblidhen, ruhen ose përpunohen këto të dhëna.
2. RATECH në rolin e tij si instalues dhe integruues, nuk ka përgjegjësi solidare me titullarin e sistemit (klientin e tij) në drejtim të mbrojtjes së të dhënave personale.
3. RATECH mund të jetë përgjegjës për ndonjë dëm material vetëm nëse ka marrë përsipër edhe të administrojë sistemin e instaluar ose integruar, pra të ushtrojë një veprimtari në të cilën kërkohet mbrojtja e të dhënave personale.
4. Vendosja e tabelave që njoftojnë se një ambient mbikëqyret me kamera apo me sisteme të tjera sigurie, të cilat mund të mblidhin, ruajnë apo përpunojnë të dhëna personale, është detyrim i titullarit të sistemit. Këto tabela duhet të identifikojnë qartë titullarin e sistemit dhe qëllimin e mbledhjes, ruajtjes apo përpunimit të të dhënave.
5. RATECH e dorëzon sistemin e instaluar ose integruar nëpërmjet një formulari dorëzimi dhe, që nga ky moment, përgjegjësia dhe detyrimet i kalojnë klientit.
6. RATECH nuk ka detyrim të informojë klientin për detyrimet që rrjedhin nga ligji për mbrojtjen e të dhënave personale.
7. RATECH do të bëjë të gjitha përpjekjet për të dokumentuar zgjedhjet ose veprimet që kanë ndikim mbi mbrojtjen e të dhënave personale.
8. Termat dhe kushtet e përgjithshme të punës së RATECH trajtojnë edhe detyrimet që ka klienti në fushën e mbrojtjes së të dhënave personale, si edhe detyrimet që ka RATECH për të dhënat që mbledh gjatë marrëdhënieve tregtare me klientët e tij.